



Demokracia në veprim është...

një burim i veçantë arsimor, që synon të zhvillojë demokracinë dhe të drejtat e njeriut në shkollë. Ky burim harmonizon veprimtaritë e gatshme mësimore me idetë për veprime konkrete në klasë.

Vizitoni materialet tona mësimore!

Mësuesit

Nxënësit

Drejtuesit

Prindërit

www.living-democracy.al

Kontakti

Për informata shtesë lidhur me faqen “Demokracia në veprim” ju lutemi kontaktoni:

Living Democracy

Mr Emir Adzovic

Emir.ADZOVIC@living-democracy.com

www.phzh.ch/ipe

Për Kosovë

Z. Arbër Salihu

Koordinator i EQD/EDNj

Arber.Salihu@ks-gov.net



Material informues dhe mësimor lidhur me
“Edukimi për Qytetari Demokratike
dhe të Drejta të Njeriut” për mësimdhënës,
nxënës, drejtorë dhe prindër.

Për projektin

Faqja e internetit “Demokracia në veprim” është burim unik edukativ, që është në dispozicion në gjuhë të ndryshme. Qëllimi i kësaj faqeje është promovimi i demokracisë dhe të drejtave të njeriut pa kosto shtesë për përdoruesit. Materialet janë të përgatitura nga edukatorët e vendeve të ndryshme dhe janë të aprovuara nga autoritetet vendore dhe Këshilli i Evropës.

Parimi i materialit mësimor të faqes së internetit bazohet në idenë se Edukimi për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut ua mundëson nxënësve të kenë rol aktiv në shkollën apo mjedisin ku ata jetojnë, i fuqizon mësimdhënësit, i mbështet udhëheqësit e shkollave dhe u jep udhëzime prindërve për komunikimin e tyre të përditshëm me fëmijët.

Qasja e përshtatshme për përdoruesit e kësaj faqeje ofron mundësi që lehtësisht të gjenden materiale sipas temave apo sipas fjalëve kyçe.

Faqja www.living-democracy.com ofron burime për mësimdhënësit, nxënësit, drejtorët dhe prindërit.

Edukimi për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut – koncepti

Edukimi për demokraci vepron në tri nivele:

- **Klasë** – si mjedis i vogël kolektiv që ofron plot mundësi për përvojat filletare në edukimin demokratik.
- **Shkollë** – si një komunitet i zgjeruar.
- **Shoqëri** – ku fëmijët dhe adoleshentët përjetojnë se çka do të thotë pjesëmarrja përmes mbrojtjes së interesave të tyre jashtë shkollës.

Materiali për Edukimin për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut, i ofruar në faqen “Demokracia në veprim”, ka për qëllim të mbështesë procesin e të nxënësve dhe t’ua mësojë nxënësve përmbajtjen e nevojshme duke i pajisur ata me kompetenca metodike dhe ato për vendimmarrje. Rubrikat e ndryshme të faqes fokusohen në kompetencat e drejtorëve si pjesë e qeverisjes demokratike të shkollës dhe në fuqizimin e prindërve.

Mësimdhënësit

- Përfitojnë njësi mësimore të gatshme për klasat 1- 11
- Kanë qasje në mëse 60 njësi mësimore, që lehtësisht u përshtaten nevojave të tyre
- Njihen me të nxënësit e bazuar në detyra
- Kuptojnë konceptet kyçe të qytetarisë demokratike dhe të drejtave të njeriut
- Shohin të drejtat e njeriut nga një perspektivë të re

Nxënësit

- Përjetojnë domethënien e demokracisë
- Mësojnë si të jetojnë së bashku në paqe
- Kuptojnë fuqinë e medieve
- Mësojnë të gjejnë zgjidhje të pranueshme për të gjithë
- Diskutojnë të ardhmen e vendit e tyre në klasë

Drejtorët

- Mësojnë të jenë udhëheqës të mirë dhe mbështetës
- Frymëzohen që të organizojnë shkollën e tyre sipas parimeve demokratike
- Gjejnë baraspeshën midis nevojave të mësimdhënësve, nxënësve, prindërve dhe shkollës
- Ndërtojnë kapacitete për jetën demokratike në shkollë
- Menaxhojnë nevojat arsimore për shekullin 21

Prindërit

- Mësojnë si të jenë shembull i mirë
- Mësojnë si të zhvillojnë forma bashkëpunuese të komunikimit me fëmijët dhe rininë
- Mësojnë si të udhëheqin fëmijën përgjatë shkollimit
- Zgjidhin konfliktet në mënyrë paqësore
- Gjejnë sugjerime për jetesë të shëndoshë – si për vete ashtu edhe për fëmijët e tyre